



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 11 shkurt 2021

Nr. ref.:RK 1703/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI50/20

Parashtrues

Abdullah Bajra

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml.nr.366/2019 të
Gjykatës Supreme, të 10 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Abdullah Bajra (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjilan, i përfaqësuar nga Shemsedin Pira, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Pml.nr.366/2019 të Gjykatës Supreme të 10 janarit 2020, në lidhje me Aktgjykimin PA1 nr.789/2019 të Gjykatës së Apelit të 16 shtatorit 2019 dhe Aktgjykimin P.nr.87/18 të Gjykatës Themelore në Gjilan-dega Kamenicë të 19 prillit 2019.
3. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), vendosjen e masës së përkohshme, për të pezulluar ekzekutimin e vuajtjes së dënimit, deri në vendimmarrjen e Gjykatës.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon t'i jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masa e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 11 mars 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Posten e Republikës së Kosovës, e cila në Gjykatë ka arritur më 13 mars 2020.
7. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 27 maj 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e formularit dhe bashkëngjitjen e dokumenteve relevante. Të njëjtën ditë një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme, në pajtim me Ligjin.
9. Më 16 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e kërkesës në Gjykatë.

10. Më 30 nëntor 2020, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të dorëzonte autorizimin e nënshkruar nga ai, si dëshmi e përfaqësimit të tij në Gjykatë nga Shemsedin Pira, avokat.
11. Më 18 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi dokumentin e kërkuar nga Gjykata.
12. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 14 maj 2018, Prokuroria Themelore në Gjilan, ngriti aktakuzën PP.II.nr.607/2018, ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të kryerjes së veprave penale nga neni 401, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK), në lidhje me mosrespektimin e masës së përkohshme të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan - dega në Kamenicë me Aktvendimin C.nr.54/18, të 18 prillit 2018 (për të mos e penguar kompaninë Air Energy në kryerjen e punimeve) dhe kryerjes së veprës penale nga neni 365 paragrafi 1, në lidhje me nenin 28 të KPRK-së.
14. Më 19 prill 2019, Gjykata Themelore në Gjilan, dega në Kamenicë, përmes Aktgjykimit P.nr.87/2018, e liron parashtruesin e kërkesës nga aktakuza përkitazi me veprën penale të përcaktuar nga neni 401.1 të KPRK-së dhe e shpall atë fajtor për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 365, paragrafin 1, në lidhje me nenin 28 të KPRK-së, duke e dënuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, dënim të cilin do ta vuante pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
15. Parashtruesi i kërkesës, brenda afateve ligjore, nëpërmjet mbrojtësit të tij parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, ndaj Aktgjykimit [P.nr.87/18] të Gjykatës Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit procedural, shkeljes së dispozitave të ligjit penal, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit në lidhje me dënimin. Kundër Aktgjykimit në fjalë, ankesë kishte ushtruar edhe Prokuroria Themelore në Gjilan, me propozimin që parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet dënim më i lartë.
16. Më 16 shtator 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PA.1 nr.789/2019, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, duke e konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.87/18 të 19 prillit 2019, me arsyetimin:

“Kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesat, të prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit dhe shkresat të era të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ka vërtetuar gjendjen faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit pati parasysh rrethanat nga neni 73 dhe 74 të KPK, ka vlerësuar të gjitha rrethanat, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari për herë të parë ka renë ndesh me ligjin, se ndaj tij nuk

zhvillohet procedurë tjetër penale, njëherësh ka pasur parasysh se vepra penale nuk është përfunduar, ka mbetur në tentative, kurse rrethana renduese në këtë çështje penale nuk gjeti, nga ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjiilan nuk ka gjetur ndonjë rrethane posaçërisht renduese, ndërsa nga ankesa e mbrojtësit të akuzuarit nuk ka gjetur ndonjë rrethane posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji i kësaj gjykate është i bindur se me këtë lloj dënimi do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit,...

17. Më 19 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PA.1.nr.789/2019, të 16 shtatorit 2019 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, P.nr.87/2018, të 19 prillit 2019, duke pretenduar në shkelje të nenit 384 paragrafi 1, nënparagrafi 12, të KPPRK-së dhe shkelje të nenit 385, paragrafi 1, nënparagrafi 1 të KPPK-së.
18. Më 10 janar 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit PML.nr.366/2019, aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e ndryshuar kështu Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, të 19 prillit 2019, përkitazi me llogaritjen e dënimit me burg efektiv, duke ia shtuar 90 (nëntëdhjetë) ditëshit edhe kohën e kaluar në paraburgim nga 26 prilli 2018, deri me 10 maj 2018, ndërsa në lidhje me pjesët e tjera kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u refuzua si e pabazuar.
19. Pjesë relevante të Aktgjykimit të sipërcekur të Gjykatës Supreme:

“Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme të mbrojtësit janë të paqarta ngase nuk mund të kuptohet se në çka konsistojnë ato, kurse edhe pse mbrojtësi i referohet shkeljes së ligjit penal nga përmbajtja e kërkesës në këtë drejtim del se këto pretendime kanë të bëjnë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Sipas dispozitës së nenit 436 par.1. të KPP me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi pretendon, mirëpo kjo gjykatë nuk mund të supozojë se çka ka dashur të thotë paraqitësi i kërkesës. Megjithatë, kjo gjykatë pasi që shqyrtoj pretendimet e lartcekura gjeti se ato janë të pabazuara.

Është evidente, se në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë theksohet se i dënuari ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurisë, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit nuk mund të shikohet dhe vlerësohet vetëm në bazë të kësaj fjalie, sepse nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese rezulton qartë mënyra, se si i dënuari ka vepruar dhe fakti se pse vepra ka mbetur në tentative (mënyrën e kryerjes e citon edhe vet mbrojtësi në kërkesë), kurse nga arsyetimi del qartë se i dënuari ka tentuar ta ndez me shkrepe lëndën djegëse-benzinën.

Kurse, pretendimet se në asnjë stad të procedurës nuk mund të vërtetohet se bidoni të cilin e ka derdhë i dënuari rreth ekskavatorit të tij ka qenë lëndë djegëse nuk ka qenë objekt shqyrtimit sepse kanë të bëjnë me

gjendjen faktike për të cilën bazë ligjore, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelen të drejtat e tij të garantuara me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, sepse *“...aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nen-paragrafi 1.12 , paragrafi 1, të nenit 384 të KPP-së. Në dispozitivin e aktgjyqimit të shkallës së parë theksohet se unë si i dënuar të kem shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurisë, mirëpo, nga dispozitivi i tillë i aktgjyqimit nuk mund të konstatohet dhe të vlerësohet vetëm në bazë të kësaj fjalie dhe se një formulim i tillë juridikisht është i paqëndrueshëm dhe se aktgjyqimin e bënë tërësisht të pakuptueshëm, aq me parë që në asnjë stad të procedurës nuk është vërtetuar se bidonin të cilin e kam derdh në afërsi të ekskavatorit tim te këtë qenë lëndë, djegëse siç mund të shihet edhe nga dëshmitë e dëshmitareve te theksuar si me poshtë e të dëgjuar në Gjykatën Themelore në Gjilan”.*
21. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: të shpallet si e pranueshme kërkesa e tij, të shpallet si jokushtetues Aktgjykimi i goditur i Gjykatës Supreme PML.nr.366/2019, i 10 janarit 2020; të urdhërohet që vendimi final i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.87/2018, i 19 prillit 2019, t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së njëjtë, dhe të shpallet si e pranueshme kërkesa e tij për masë të përkohshme, lidhur me ndalimin e fillimit të vuajtjes së dënimit të shqiptuar me Aktgjykimin P.nr.87/2018, të 19 prillit 2019, derisa Gjykata të vendos për çështjen.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregulloren të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

24. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47

[Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

25. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar dhe e konteston një akt të autoritetit publik, i nijeti i ka shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, ai gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

26. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënregullin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

27. Gjykata, fillimisht përsërit se përkitazi me shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

28. Në lidhje me rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 30 dhe 31 të Kushtetues dhe nenin 6 të KEDNj-së, duke

i ndërlidhur shkeljet e të drejtave të tij kushtetuese me mënyrën e vërtetimit të gjendjes faktike dhe të interpretimit dhe aplikimit të dispozitave të KPPRK-së, përkatësisht nenparagrafi 12, paragrafit 1, të nenit 384 të këtij Kodi.

29. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesë e ka ndërtuar rastin e tij në baza “ligjshmërie” dhe jo në baza “kushtetutshmërie”. Gjykata në mënyrë të përsëritur ka theksuar se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KIO6/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 60).
30. Në mënyrë konsistente, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
31. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58 dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 62).
32. Megjithatë Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
33. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një

rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës (përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

34. Në këtë aspekt, Gjykata duhet të theksojë se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar para Gjykatës (i) arsyet të cilat do të mund të mbështesin pretendimin se në rrethanat e rastit konkret, nenet përkatëse të ligjit penal dhe procedural janë interpretuar nga gjykatat e rregullta në “*mënyrë qartazi të gabuar*”; dhe (ii) se si një interpretim i tillë, ka rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.
35. Gjykata në këtë këndvështrim, vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me aplikimin e gabuar të KPRK-së dhe KPPRK-së, janë adresuar dhe arsyetuar nga gjykatat e rregullta, sidomos nga Gjykata Supreme, e cila pjesërisht e aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë sa i përket llogaritjes së sanksionit penal, në dobi të parashtruesit të kërkesës, duke dhënë edhe arsye të detajuara për refuzimin si të pabazuara të pretendimeve të tjera të goditura me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë (shih, për me tepër arsyetimin e Gjykatës Supreme, në paragrafin 18 të këtij dokumenti).
36. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nuk ka asgjë që tregon se gjykatat e rregullta kanë “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”, aplikim i cili do të mund të rezultonte në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.
37. Gjykata më tej rithekson se, në parim, “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktikë, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës përkatëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; KI118/18, me parashtrues *Eco Construction sh.p.k*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 48; dhe KI49/19, parashtrues: *Limak Kosovo International Airport SH.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim për papranueshmëri i 8 janarit 2020, paragrafi 55).
38. Kjo nënkupton, se palëve duhet mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; duhet akorduar mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që janë relevante për zgjidhjen e një rasti janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura janë shtruar dhe arsyetuar hollësisht dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/17, Parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi

- 29). Gjykata konsideron, se në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.
39. Më tej dhe në fund, Gjykata thekson se neni 6 i KEDNJ-së, nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
40. Nga si mësipër, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta kane respektuar kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së, ku përfshihen dhe të drejtat e të akuzuarit, duke i dhënë mundësi parashtuesit të kërkesës që t'i paraqesë kundërshtimet e tij përkitazi me provat dhe dëshmitë në lidhje me akuzat e ngritura kundër tij, dhe atë në çdo fazë të procedurës së ndjekur. Për me tepër, të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura janë shtruar dhe arsyetuar hollësisht dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk ishin të padrejta.
41. Gjykata në këtë aspekt thekson se parashtuesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
42. Prandaj në këto rrethana, bazuar si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës.
43. Rrjedhimisht kërkesa e parashtuesit të kërkesës në baza kushtetutës është qartazi e pabazuar, andaj në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës e njëjta duhet deklaruar e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

44. Gjykata rikujton që parashtuesi i kërkesës ka kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg efektiv, deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës. Gjykata sapo ka konkluduar se kërkesa e tij duhet deklaruar e papranueshme, në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
45. Andaj, në pajtim me nenin 27 (1) të Ligjit dhe rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtuesit të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme duhet refuzuar, sepse e njëjta nuk mund të jetë më tutje objekt i shqyrtimit, pasi kërkesa u deklarua e papranueshme, në baza kushtetuese (shih

rastet e Gjykatës KI159/18, parashtrues: *Azem Duraku*, Aktvendimi i 3 prillit 2019, paragrafi 91; KI13/19 parashtrues: *Fevzi Hajdari*, Aktvendimi i 12 prillit 2019, paragrafi 75; dhe së fundmi rastet e bashkuara KI19/19 dhe KI20/19, ku parashtrues ishin vet parashtruesit e kërkesave, Aktvendimi i 29 korrikut 2019, paragrafët 53-55).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 27 (1) të Ligjit dhe të rregullave 39 (2), 57 (4) (a), si dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

